



Qendra e koordinimit
KUNDËR
EKTREMIZMIT të
DHUNSHËM
-Shqipëri

RAPORT

KORRIK – DHJETOR 2022



MINISTRIA E BRENDSHME

QENDRA E KOORDINIMIT

KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

info@cve.gov.al

www.cve.gov.al

SHKURTESA

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	QKEDH
Parandalimi dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit të Dhunshëm	P/KEDH
Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Strategjia Kombëtare
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	MSHMS
Ministria e Brendshme	MB
Ministria e Mbrojtjes	MM
Ministria e Drejtësisë	MD
Ministria e Financës dhe Ekonomisë	MFE
Ministria e Arsimit dhe Sportit	MAS
Organizata Ndërkombëtare për Migracionin	IOM
Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë të Komunitetit	GCERF
Komisioni Evropian	KE
Rehabilitimi dhe Ri- integrimi	R&R
Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social	IANS
Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore	AMVV
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Siria dhe Iraku	Qendra Pritëse
Luftëtarëve të Huaj Terroristë	LHT
Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve	DPB
Autoritetin Kombëtar për Certifikim Elektronik	AKCESK
Instituti i Kërkimit të Krimin Ndër-Rajonal dhe të Drejtësisë së	UNICRI
Kombeve të Bashkuara	
Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes	CSDG
Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare	QNLQ
Organizata të Shoqërisë Civile	OSHC

PËRMBAJTJA

SHKURTESA	2
PËRMBAJTJA	3
1. HYRJE	4
2. ZBATIMI I PLANIT TË RI-INTEGRIMIT	8
3. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RRITJA E KAPACITETEVE	13
4. KOMUNIKIMI STRATEGJIK	15
5. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL, NDËRKOMBËTAR	16
6. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES	25
7. PROBLEMATIKA	26

1. HYRJE

Ky dokument paraqet një përmbledhje mbi aktivitetin e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) për periudhën gjashtë mujore “korrik- dhjetor 2022” dhe është hartuar duke evidentuar aktivitetet kryesore të kryera bazuar në objektivat institucionale të QKEDH. Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” dhe VKM nr. 237 dt. 20/04/2022 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 737 dt. 13/12/2017 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”, QKEDH është e angazhuar në koordinimin dhe monitorimin e punës me institucionet qendrore, vendore dhe partnerët ndërkombëtarë për proceset e parandalimit të radikalizmit, kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe pritjes dhe akomodimit të shtetasve të rikthyer nga zonat e konfliktit si dhe zbatimit të planeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit.

Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm ka punuar sistematikisht dhe me intensitet për të përmbushur aktivitetin e saj koordinues ndër-institucional në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm duke zbatuar Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin Kombëtar të Veprimit (P/KEDH), ka vijuar zbatimin dhe monitorimin e procesit të katërt të riatdhesimit të shtetasve shqiptarë të mbetur në kampet e vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak; të procesit të ri-integrimit të personave të riatdhesuar nga këto kampe në Tetor të vitit 2020, Gusht 2021, Maj 2022; si dhe realizimin e objektivave të Planit të Veprimit P/KEDH.

Dinamika e aktivitetit gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2022, u fokusua në zbatimin e veprimtarisë së planifikuar në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me partnerët apo aktorët e ndryshëm të shoqërisë për përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit. Ky aktivitet përfshin:

- ✓ ndjekjen e procesit të koordinimit të të gjithë strukturave shtetërore dhe organizatave të përfshira për ri integrimin dhe risocializimin në komunitet të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 01 Gusht 2021, 5 (pesë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27.10.2020 si dhe të 13 (trembëdhjetë shtetasve

shqiptarë që u riadhesuan me datë 27.05.2022 të cilët pas fazës së rehabilitimit në Qendrën Pritëse, janë tashmë pjesë e procesit të ri-integrimit dhe risocializimit në komunitet;

- ✓ koordinimin e punës dhe orientimin e partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbështetës të procesit të rehabilitimit, ri-integrimit dhe të risocializimit (RRR) të shtetasve të kthyer;
- ✓ hartimin i Strategjisë Ndër-sektoriale të Luftës kundër Terrorizmi dhe Planin e Veprimit për Ekstremizmin e Dhunshëm si dhe ndjekja e fazave të konsultimit publik dhe pasqyrimi i komenteve me qëllim dërgimin për fazën e miratimit;
- ✓ promovimin dhe mbështetjen e rolit të shoqërisë civile në zbatimin e plotë të veprimit të P/KEDH-së në koordinim me institucionet e linjës;
- ✓ nxitjen e kontributit me ide – propozimet e kërkuara QKEDH-së, në kuadër të zbatimit të P/KEDH me qëllim tërheqjen e garantëve të vogla të publikuara nga donatoret mbështetës të Qeverisë Shqiptare në fushën e P/KEDH; (Ref. OSHC-ve, Organizata të Shoqërisë Civile, lidhur me garantët e akorduara nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, etj.);
- ✓ mbështetjen dhe promovimin e OSHC-ve shqiptare në kuadër të idesë së partneritetit publik-privat me qëllim forcimin e rolit të tyre, por edhe thithjen e fondeve të akorduara nga organizata ndërkombëtare GCERF (Fondi Global për Angazhimin dhe Qëndrueshmërinë e Komunitetit), me qëllim kontributin dhe impenjimin e OSHC-ve për të përfutur mbështetje të konsiderueshme ndërkombëtare në kuadër të objektivave dhe zbatimit të aktiviteteve të P/KEDH në Shqipëri.

Gjatë periudhës raportuese, në koordinim me të gjithë institucionet dhe aktorët e përfshirë, QKEDH ka koordinuar fazat e procedurave ligjore, mjekësore, psiko-sociale dhe të rehabilitimit, të cilat zhvillohen në Qendrën Pritëse, ku ishin akomoduar 13 (trembëdhjetë) shtetasit shqiptarë që u riadhesuan më datë 27.05.2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak.

Gjithashtu, QKEDH në bashkërendim me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve të Njësisë Administrative (NJA) përkatës, psikologë dhe përfaqësues të Shërbimit Ligjor Falas (TLAS), Drejtorisë së Antiterrorit dhe strukturave të Policimit në Komunitet të Policisë së Shtetit, Rrjetin e Mësuesve Koordinatorë në nivel Kombëtar, Organizatat e Shoqërisë Civile, ka identifikuar dhe bashkërenduar punën për trajtimin e çështjeve të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm si dhe

shfaqjeve të fenomeneve të reja apo që rrjedhin nga situata e personave të rikthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak, në fazë rehabilitimi apo në fazë ri-integrimi në komunitet.

Lidhur me rastet të identifikuar dhe të raportuara ndaj institucioneve të ngarkuar me zbatimin e VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku”, QKEDH ka vijuar aktivitetin e grumbullimit të informacioneve, raporteve dhe koordinimin mbi zbatimin e procesit të ri-integrimit të 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan me datë 27 maj 2022, 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 1 Gusht 2021, si dhe të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar në 27 tetor 2020 nga vendet e konfliktit (Siri dhe Irak). Për më tepër, QKEDH ka vijuar me realizimin e objektivave të Planit të Veprimit (P/CVE), Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe të Planit të Veprimit”, Vendimin nr.1137, datë 16.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndër sektoriale të luftës kundër terrorizmit” 2021–2025, dhe plani i veprimit 2021–2023, Planit të Veprimit Ndërinstitucional “Për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat e konfliktit Siri/Irak” miratuar me Urdhrin nr. 169 të Kryeministrit, datë 1 nëntor 2018), Strategjisë Kombëtare për Sigurinë e Republikës së Shqipërisë, në fuqi nga Korriku 2014.

Gjatë periudhës raportuese ka përfunduar faza hartimit dhe konsultimit publik për Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022-2025 dhe Planet e Veprimit në zbatim të saj të cilët janë konceptuar në dy dokumente specifike, një për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe një për Luftën kundër Terrorizmit. Theksohet se Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022-2025 është vazhdim i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2011–2015, si detyrim i vendit për përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT). Ky dokument strategjik përfaqëson një vëmendje të shtuar ndaj

parandalimit dhe luftimi të akteve terroriste, parandalimin e kundërshtimit e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet krijimit dhe reformimit të komuniteteve dhe institucioneve më të qëndrueshme, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar dhe të kthyerve nga zonat e konfliktit dhe familjeve të tyre, zhvillimin e një komunikimi strategjik dhe parandalimin e kundërshtimit e radikalizimit online. Kjo strategji do të shërbejë si instrumenti kryesor për të bashkërenduar ndërveprimin institucional kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit

Strategjia bazohet njëkohësisht edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare në kuadër të fuqizimit të sigurisë dhe mbrojtjes ku një ndër objektivat kryesorë është ngritja e mekanizmave që garantojnë komunikimin, bashkërendimin dhe bashkëpunimin efektiv ndërinstytucional mes aktorëve kryesorë të sigurisë kombëtare, përmes forcimit të bashkëpunimit dypalësh dhe me institucionet e specializuara rajonale dhe ndërkombëtare për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, trafiket e paligjshme, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

QKEDH ka nxitur angazhimin e institucioneve kompetente shtetërore dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore, rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe aksesueshmërisë së tij si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional. Gjatë periudhës raportuese është përmirësuar bashkëpunimi ndërsektorial mes strukturave që koordinojnë realizimin e masave në zbatim të planeve të veprimit.

Vlen të theksojmë së gjatë periudhës raportuese kanë përfunduar fazat e përgatitjes dhe pritjet të miratohen dy Projektvendime dhe një Urdhër i Kryeministrit përgjatë 4 mujorit të parë të vitit 2023:

- ✓ 1- “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit (AKTE)” – (aktualisht në fazën e konsultimit me institucionet e tjera)
- ✓ 2- “Urdhër për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë kundër terrorizmit dhe ekstremizmit (AKTE)” – (aktualisht në fazën e konsultimit me institucionet e tjera)
- ✓ 3- “Urdhër për krijimin e komitetit rajonal të parandalimit të radikalizimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”. – (përfunduar konsultimi me institucionet e tjera, në pritje miratimi)

2. ZBATIMI I PLANIT TË RI-INTEGRIMIT

Gjatë periudhës raportuese QKEDH ka vijuar aktivitetin koordinues mbi zbatimin e procesit të rehabilitimit në Qendrën Pritëse Durrës për 13 (trembëdhjetë) shtetasit shqiptarë që u riatdhesuan më datë 27.05.2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak, si dhe procesin e tyre të integritimit në komunitetet pas daljes nga QP; ri-integrimit të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë të riatdhesuar më datën 1 Gusht 2021; koordinimin dhe monitorimin e procesit të ri-integrimit të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar në 27 Tetor 2020 nga këto vende (Siri dhe Irak), si dhe me realizimin e objektivave të Planit të Veprimit (P/CVE).

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga VKM (konfidenciale) nr. 453, datë 29/07/2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 826, datë 26.10.2020 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin e shërbimeve për pritjen dhe akomodimin e fëmijëve të pashoqëruar të kthyer nga Siria dhe Iraku” për 13 (trembëdhjetë) shtetasit shqiptarë që u riatdhesuan gjatë fazës së 4-të të riatdhesimeve më datë 27.05.2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak, 10 (dhjetë) fëmijë dhe 3 (tre) gra, të cilët u akomoduan në ambientet e Qendrës Pritëse (në Shtëpinë e Pushimit të Ushtarakëve) Durrës, QKEDH koordinoi dhe bashkërendoi me institucionet përkatëse përmbushjen me sukses të fazës së rehabilitimit; QKEDH ka vijuar me koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të cilat zhvillohen në kuadër të zbatimit të procesit të ri-integrimit të tyre pas vendosjes së tyre në komunitet.

Në zbatim të planit të integritimit të 13 (trembëdhjetë) shtetasve të kthyer nga zonat e konfliktit, QKEDH bashkërendoi me të gjithë aktorët e përfshirë në proces: Bashkinë Tiranë (Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve), Specialistët e Policimit të Zonës (SPZ) dhe Drejtorinë e Antiterrorit të Policisë së Shtetit, Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) dhe Zyrën e Antitrafikut procedurat ndjekura bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit (PSV). Procesi i kthimit në komunitet të të gjithë të kthyerve të fazës së katërt të riatdhesimeve përfundoi konkretisht në muajin Nëntor, muaj në të cilin është vijuar me mbylljen e Qendrës Pritëse.

QKEDH ka zhvilluar 24 takime të Grupeve Teknike Ndër-sektoriale (GTN) të ngritura për të trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me të 5 (pesë) familjet.

QKEDH gjithashtu ka koordinuar dhe zhvilluar takime me Punonjës të Mbrojtjes Fëmijëve (PMF) në Bashkinë Tiranë (BT), Drejtoreshën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe

Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF), përfaqësues të Fshatit SOS në QP për të njohur PMF-të me rastet përkatëse të cilët janë vendosur në Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë (NJA), si dhe me përfaqësuesin e fshatit SOS i cili ka mbështetur të mitur të pashoqëruar nga prindërit. QKEDH ka kryer koordinimin me të gjithë aktorët e përfshirë në proces, si dhe me organizatën Terre des Homme (TdH) për mbështetjen me paketa humanitare, mbështetje psikologjike dhe mësues ndihmës në mënyrë që procesi i integritit të zhvillohet në mënyrë sa më të butë dhe efektive.

Mbështetje psikologjike e garantuar për përfituesit ka përfshirë: kryerjen e sesioneve individuale me fokus në këshillimin psikologjik, aktivitete psikosociale, psikoedukim dhe aplikim të testeve të nevojshme të vlerësimit; zbatimin e teknikave të artit dhe lojës gjatë seancave me fëmijë që ndjekin moshën, vështirësitë dhe zhvillimin përkatës të fëmijës; zbatimin e testeve projektive për të kuptuar problemet rrënjësore dhe për të parë dinamikën e familjes, çështjet e komunikimit dhe ndërveprimin; aplikimi i teknikave me qasje psikoanalitike gjatë seancave individuale me prindërit; si dhe aplikimi i teknikave të terapisë në grup me kombinimin e një qasjeje të orientuar drejt familjes.

Në kuadër të rifillimit të vitit të ri akademik, me koordinim të QKEDH u zhvillua takim me përfaqësues të Bashkisë së Tiranës, Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) dhe mësuesit mbështetës ku u siguroa mbarëvajtja e procesit mësimor për të gjithë fëmijët e riatdhesuar të cilët do të ndjekin procesin arsimor.

Gjatë muajit shtator, QKEDH në kuadër të integritit të fëmijëve në shkollë, në bashkëpunim me ZVA Tiranë ka koordinuar procesin e regjistrimit në shkollë të fëmijëve .

Për angazhimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga zonat e konfliktit (përveç të riatdhesuarve të dt. 27.05.2022 që do të vijojë në një fazë të dytë) drejt kurseve profesionale si dhe fëmijët e tyre në kurse të gjuhëve të huaja, QKEDH ka koordinuar me Drejtorinë e Shërbimit Social angazhimin e tyre në këtë drejtim. Këto kurse janë mundësuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në vijim të projektit “Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga kjo organizatë, me mbështetjen e Fondit Global të Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (GCERF), ku nëpërmjet “Consortium-it WCDA” mundësohet kryerja e këtyre kurseve për të gjithë të riatdhesuarit.

Lidhur me procesin e ri-integrimit të të kthyerve në komunitet të fazës së katërt të riatdhesimeve, QKEDH ka zhvilluar disa takime me të afërmit e tyre për çështje që kanë të bëjnë me çështjen marrjen e kujdestarisë së të miturve dhe çështje të strehimit pas daljes në komunitet, etj.

Në kuadër të procesit të ri-integrimit të të kthyerve të datës 27.05.2022, aktiviteti i QKEDH-së është fokusuar në koordinimin me PMF-të përkatëse për identifikimin e nevojave të tyre dhe adresimin të organizatave mbështetëse: Terres de Hommes (TdH) dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV). Këto organizata mbështesin në vazhdim të gjitha familjet me plotësimin e nevojave të paraqitura për veshmbathje, mjete didaktike dhe paketa humanitare.

QKEDH ka grumbulluar raportimet dhe bashkërendon punën me punonjësit e Mbrojtjes për Fëmijë (PMF) që janë menaxherë të rasteve të cilët kanë dhe vazhdojnë të monitorojnë proceset e zhvilluara për njësitë familjare të këtyre shtetaseve dhe psikologët që kanë vazhduar me seancat këshilluese në kuadër të terapisë që zbatohet si për nënat dhe të miturit.

Në vijim të procesit të menaxhimit të rasteve të të gjithë fëmijëve të kthyer nga zonat e konflikti në datën 10.11.2022 u zhvilluan GTN-në përkatëse për të shqyrtuar ecurinë e procesit për të gjitha rastet e të riatdhesuarve, me të gjithë aktorët e përfshirë në proces: përfaqësues të Bashkisë Tiranë, Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF), përfaqësues të organizatave mbështetëse, psikologë, mësues mbështetës për të diskutuar mbi çështjet e strehimit, procesit mësimor dhe çështje të tjera të integrimit të tyre në komunitet, proces i cili vazhdon të monitorohet nga QKEDH.

Ndër të tjera, gjatë periudhës raportuese, QKEDH ka zhvilluar në mënyrë të rregullt takime me përfaqësues të organizatës Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGV) mbi vazhdimin e mbështetjeve me paketa humanitare, mësues mbështetës, mbështetje psikologjike dhe teolog të familjeve që po mbështetin deri me tani.

Gjithashtu, QKEDH ka bashkërenduar me Zyrën Vendore Arsimore (ZVA) dhe PMF-të e rastit për ndryshimin e klasave të disa fëmijëve të familjeve të rikthyera duke i regjistruar në ciklin parashkollor pas kërkesës së nënës për shkak të mangësive që fëmijët shfaqin nga mos frekuentimi i klasave në procesin arsimor deri tani. Gjithashtu, QKEDH koordinoi me ZVA kalimin në klasë të dytë të rasteve përkatëse për arsye të vështirësive që kanë nga mos frekuentimi i procesit mësimor.

Mbi ecurinë e rasteve specifike dhe rastet e të rikthyerve të zonës së Cërrikut deri tani në procesin e ri-integrimit, dhe vazhdimin e ofrimit të kësaj mbështetjeje në vazhdim, QKEDH ka zhvilluar takime me psikologët mbështetës duke analizuar secilin rast me qëllim identifikimin dhe adresimin e problematikave të hasura në kohë.

Problematika janë hasuar në procesin mësimor për fëmijët e rikthyer të datës 27.05.2022 të cilët kanë shumë mangësive shkak të qëndrimit në zonat e konfliktit për shumë vite për të cilën, QKEDH ka zhvilluar takime me mësuesit mbështetës, lista e të cilëve u mundësua në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore. Këta mësues do të lehtësojnë procesin mësimor për fëmijët e rikthyer të datës së mësipërme me qëllim krijimin e kushteve dhe ri integrimin mësimor dhe sociale të tyre sipas grupmohave respektive.

Me mbylljen e Qendrës Pritëse dhe sistemimin e të të kthyerve, gjatë muajit Nëntor, QKEDH bashkërendoi me Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) kryerjen e procedurave të regjistrimit në Gjendjen Civile. Pas koordinimit të QKEDH-së me ZVA dhe PMF-të përkatëse për regjistrimin në shkolla të fëmijëve, të gjithë fëmijët kane filluar të ndjekin rregullisht procesin arsimor, përveç fëmijëve ,me përjashtim të një familje, të cilët janë në proces regjistrimi dhe së shpejti do te fillojnë të ndjekin mësimin.

Punonjësit e Mbrojtjes për Fëmijë (PMF) që janë menaxherë të rasteve sipas familjeve respektive të të kthyerve, kanë monitoruar proceset e zhvilluara për njësitë familjare të këtyre shtetaseve. Psikologët kanë vazhduar me seancat këshilluese në kuadër të terapisë që zbatohet si për nënat dhe të miturit.

QKEDH po vijon koordinimin dhe monitorimin me të gjithë aktorët e përfshirë në proces në mënyrë që procesi i integrimit të të kthyerve të zhvillohet në mënyre sa më efektive.

Në vijim të procesit të ri-integrimit dhe të gjitha rezultateve të marra nga psikologët e Shërbimit Social mbi gjendjen e përfituesve u bë e mundur me mbështetjen e partnerit Terre de Homme, ofrimi i shërbimit shtesë me psikologe të jashtëm, me eksperience për moshat adoleshente për të trajtuar rastet e krizave dhe shpërthimeve emocionale, që disa prej të riatdhesuarve manifestonin, si pasojë e stresit post traumatik. Me anë të këtij shërbimi psikologia mbështetëse e specializuar për moshat adoloshente kërkoi shërbim më profesional nga një psikiatër ekspert për rehabilitim.

Për të vijuar procesin me siguri dhe profesionalizëm u bë e mundur vënia në dispozicion e një psikiatri të specializuar nga partneri jonë mbështetës, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza.

Në përmbushje të të gjithë këtij procesi, u punua njëkohësisht edhe me shërbimin ligjor i cili është mundësuar dhe vazhdon mbështetjen nga Tirana Legal Aid Society (TLAS) mbështetur financiarisht nga UNICEF. Ky proces është kompleks dhe dinamik për nga natyra sensitive dhe statusi që përfituesit mbartin që prej largimit të tyre. Gjendja përgjatë periudhës raportuese përfshirë për rastet nga riatdhesimi i parë e deri në riatdhesimet e fundit është si më poshtë:

- ✓ Gjithsej janë hapur 37 (tridhjetë e shtatë) çështje ligjore për të cilat TLAS-si ofron shërbimin ligjor për personat e kthyer. Duke qenë se procesi i regjistrimit të fëmijëve zgjat në kohe sepse nevojitet të vërtetohet amësia nga rezultati i analizës së ADN-së, 28 (njëzet e tetë) prej çështjeve vazhdojnë të jenë në proces ndërsa 9 (nëntë) të tjera janë të përfunduara me sukses, nga të cilat 2 (dy) janë çështje të regjistrimit të fëmijëve të kthyer në fazën e parë të riatdhesimit.
- ✓ Përfituesit gjatë proceseve gjyqësore kanë si përfaqësues të tyre avokatët mbështetës të TLAS si dhe marrin asistencë ligjore familjare të vazhdueshme.
- ✓ QKEDH ka koordinuar dhe realizuar takime edhe online me PMF-të pranë Bashkisë Tiranë që janë angazhuar me menaxhimin e këtyre shtetasve për monitorimin e procesit që po realizohet.
- ✓ Si rezultat i bashkëpunimit me PMF-të e Njësi Administrative (NJA) respektive, QKEDH ka organizuar tre takime individuale me shtetasit e riatdhesuara nga ish vendet e konfliktit Siri dhe Irak ku morën pjesë edhe përfaqësues të Shërbimit Ligjor Falas (TLAS) dhe të Drejtorisë së Antiterrorit të Policisë së Shtetit, ku shtetasit në fjalë u njohën me procesin ligjor që po zhvillohet si dhe me detyrimet që ato kanë.
- ✓ Për secilin prej rasteve të sipër shkruar ka vijuar mbështetja nga organizatat bashkëpunuese zbatuese në këtë proces me paketa ushqimore periodike, me pagesën e ujit dhe dritave sipas rasteve që e kanë shfaqur si nevojë, apo dhe për të tjera si nevoja të identifikuar.
- ✓ Numri i organizatave të përfshira në proceset RRR është rritur nga 6 në 15, duke forcuar kështu mbështetjen dhe rolin e shoqërisë civile.

3. AKTIVITETE INFORMIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE RRIJJA E KAPACITETEVE

Në zbatim të dhe Vendimit Nr 1137, datë 16.12.2020 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit, 2021-2025, dhe Planit të Veprimit 2021-2023”, një rëndësi të veçantë, QKEDH i ka kushtuar dhe aktiviteteve të ndryshme me qëllim ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe punonjësve të administratës së përfshirë në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si një metodë efikase për të arritur qëllimin e synuar sikurse dhe aktivitete të ndryshme për rritjen e kapaciteteve, në veçanti të punonjësve të vijës së parë për identifikimin e shenjave të hershme të radikalizmit që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.

Për këtë arsye, QKEDH dhe CSDG bashkë-organizuan një workshop në kuadër të projektit "Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe mekanizmave të Komunikimit Strategjik në funksion të Parandalimit/Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm" ku morën pjesë: Ministria Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Mësues, Psikolog dhe Punonjës Social. Nëpërmjet këtij workshopi, punonjësit e vijës së parë tanimë profesionistët që morën pjesë janë pajisur me njohuritë e duhura për identifikimin e shenjave të hershme të radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm, sikurse ka një sensibilizim më të gjerë për luftimin e këtij fenomeni.

Gjithashtu, përgjatë kësaj periudhë raportimi, QKEDH ka koordinuar takimet që u mbajtën në Tiranë nga data 6-9 shtator me përfaqësues të GCERF, ku u diskutua mbi programet dhe aktivitetet të cilat janë implementuar, ato të cilat do të implementohen dhe fushat ku duhet të fokusohen më shumë në të ardhmen në programet P/CVE dhe R&R në Shqipëri.

Në kuadër të fuqizimit ekonomik për gratë e rikthyera nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak, QKEDH ka zhvilluar takime të herë pas hershme me përfaqësuesen e Woman Center For Development and Culture Albania, e cila është pjesë e konciorsumit të IDM. Objektivi i takimeve ka qenë trajnimet që jep DRFPP Nr 1 Tiranë, në bashkëpunim me, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive me qëllim mundësimin dhe organizimin e kurseve të trajnimit profesional për të gjithë punëkërkuarit e papunë dhe për të gjithë të interesuarit që duan kualifikime të mëtejshme.

Në vijim të projektit “Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria”, i cili po zbatohet në Shqipëri nga organizata IDM, me mbështetjen e GCERF, ku nëpërmjet Consortium-it WCDA mundësohet kryerja e kurseve profesionale dhe kurset e gjuhës

angleze për të rikthyerit, QKEDH identifikoi nevojat e të rikthyerve dhe koordinoi me BT (nëpërmjet PMF-ve) organizimin e kurseve të trajnimit profesional të cilat vazhdojnë të monitorohen nga QKEDH. Consortium-i WCDA në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive ka mundësuar organizimin e kurseve të trajnimit profesional për të gjithë punëkërkuessit e papunë dhe për të gjithë të interesuarit që duan kualifikime të mëtejshme. Në fund të kursit çdo kursant që ndjek rregullisht kursin pajiset me certifikatën respektive të trajnimit.

Po gjatë periudhës së raportimit, QKEDH në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ka zhvilluar forumin me temë: “Promovimi i harmonisë dhe tolerancës fetare në komunitetet vendore” në zonën e Përrenjasit, Kavajës, Kukësit dhe Burrelit. Në këtë forum u diskutua mbi promovimin e vlerave, tolerancës dhe harmonisë fetare për lehtësimin e procesit të ri-integrimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit, forcimin e bashkëpunimit dhe partneritetit mes komuniteteve fetare dhe institucioneve vendore në zbatimin e ndërhyrjeve R&R, si dhe rëndësinë e këshillimit fetar për R&R e të rikthyerve në komunitet.

Gjithashtu, QKEDH në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ka zhvilluar dy trajnime me temë: “Konteksti i ekstremizmit të dhunshëm (EDH) në Shqipëri dhe qasja multidisiplinare për rehabilitimin dhe riintegrimin (R&R) e personave të kthyer nga zonat e konfliktit” në kuadër të programit "Ri-integrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria" në Kavaje dhe Burrel, Kukës. Qëllimi i këtij trajnimi ka qenë fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve të vijës së parë për një qasje efektive shumë aktoriale në zhvillimin dhe zbatimin e praktikave R&R për të kthyerit nga zonat e konfliktit.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të stafit, QKEDH mori pjese në trajnimin e organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me zbatimin e standardeve ndërkombëtare IPSIAS, të përshtatura për kontabilitetin dhe financat, i cili u zhvillua në datat 18-21 Tetor 2022.

Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik, QKEDH koordinoi me organizatën TdH në Shqipëri organizimin e workshop-it konsultues mbi procedurat standarde të veprimit për rehabilitimin dhe riintegrimin fillestar të personave të kthyer nga zonat e konfliktit. Workshop-i zhvillohet në kuadër të projektit ”Parandalim dhe riintegrim i sigurt: Qasje holistike dhe e qëndrueshme ndaj

ekstremizmit të dhunshëm” i cili po zbatohet në partneritet me QKEDH në pesë rajone: Tirana, Durrësi, Dibra, Korça, Elbasani, Kukësi, me mbështetjen financiare të GCERF-it (Global Community Engagement and Resilience Fund).

Bazuar në mësimet e nxjerra nga proceset e shkuara të riatdhesimit, QKEDH ka hartuar procedurat standarde të veprimit me qëllim miratimin e tyre si procedura standarde në rang kombëtar. Për këtë arsye, QKEDH në bashkëpunim me organizatën Terre des Hommes ka zhvilluar 2(dy) workshop-e me temë: “Për konsultimin dhe përmirësimin e Draft- Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për rehabilitimin dhe ri-integrimin fillestar të të kthyerve nga zonat e konfliktit për profesionistët e linjës së parë”. Në “workshop” janë mbajtur diskutime mbi qëllimin e PSV, shpjegimi i termave dhe grupeve të synuara të PSV, parimet mbi të cilat është bazuar PSV, parimet që duhet të udhëheqin punën e profesionistëve të përfshirë në pritjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve, procedurat e asistimit të fëmijëve dhe grave të kthyer.

Nisur nga fakti që Lufta kundër Terrorizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm në të gjitha format dhe llojet e saj është fusha kryesore e QKEDH si dhe nisur dhe nga ngjarja e fundit në rrugën 5 Maj ku një qytetar mbante të ngujuar dhe dhunuar dy fëmijët e tij për një periudhë disa vjeçare, QKEDH i ka kushtuar një rëndësi të veçantë trajtimit të këtij fenomeni nëpër shkolla. Për këtë arsye, QKEDH në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë ka organizuar trajnimin bazë për 128 oficerë të rinj të sigurisë në institucionet arsimore para universitare në Shqipëri për “Parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në shkolla”. Ky trajnim është pjesë e Programit Bazë të detyrueshëm për oficerët e rinj të sigurisë dhe orienton profilizimin e tyre për ndërhyrje të efektshme, në ndihmë të stafit pedagogjik në shkolla, në të gjithë territorin e Shqipërisë.

4. KOMUNIKIMI STRATEGJIK

Në përmbushje të objektivit Komunikimi Strategjik dhe në funksion të transparencës mbi aktivitetin që kryen, QKEDH ka publikuar në mënyrë të vazhdueshme në faqen e saj zyrtare të web, aktivitetet e ndryshme që janë zhvilluar në këtë drejtim.

Gjithashtu, QKEDH ka zhvilluar një takim informues–ndërgjegjësues me nxënësit e shkollave 9-vjeçare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në bashkëpunim me Shoqatën Internacionale për Solidaritet (SHIS).

5. BASHKËPUNIME ME PARTNERË NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL, NDËRKOMBËTAR

Në mënyrë paralele me zbatimin e detyrimeve funksionale për P/KEDH dhe Procesin R&R&R, QKEDH, ka vijuar punën në kuadër të procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2022-2024 për ekstremizmin e dhunshëm dhe Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën ndaj Terrorizmit.

QKEDH ka realizuar në terma konkret një rrjet të gjerë të përbërë nga aktorë qendrorë dhe vendorë, nga ministritë e linjës dhe strukturat e tyre në varësi, aktorë të shoqërisë civile me një bazë të dhënash me më shumë se 12,000 (kontakte) aktorë të vijës së parë që kanë të bëjnë me komunitetet, që kanë ndjekur trajnime dhe/ose sesione informuese/sensibilizuese në kuadër të ngritjes së kapaciteteve për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe shtyllës së komunikimit strategjik të institucionit.

QKEDH ka koordinuar pajisjen e shkollave me një plan veprimi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel kombëtar për fuqizimin e aktorëve të vijës së parë, dhe duke filluar nga viti 2018 është ngritur rrjeti i mësuesve koordinues (gjithsej 1900 mësues) në të gjitha shkollat e ciklit para-universitar në shkallë vendi. Gjithashtu, me një marrëveshje dypalëshe mes Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, u krijua struktura e Oficerëve të Sigurisë së Shkollave (OSSH), një risi e sistemit arsimor shqiptar në kuadër të garantimit të një shkolle të sigurt dhe miqësore, ku konkretisht 150 oficerët e parë kanë marrë trajnimin e nevojshëm për të identifikuar, trajtuar dhe parandaluar sjelljet radikale/ekstreme të dhunshme brenda ambienteve të institucioneve arsimore.

Qeveria e Shqipërisë në një nga objektivat e saj të Presidencës së OSBE-së ka theksuar rolin dhe kontributin e çmuar që Partneritetet Publike Privat (PPP) mund të japin në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit nëpërmjet krijimit të partneriteteve të qëndrueshme dhe të vijueshme që kontribuojnë në forcimin e besimit të ndërsjellë me sektorin privat për çështjet e sigurisë.

QKEDH ka pasur një fokus të vazhdueshëm në sektorin privat nëpërmjet përfaqësuesve të Dhomës së Tregtisë në Shqipëri por edhe vetë biznesit në terma të fuqizimit të bizneseve fillestare të të rinjve. Një qasje e tillë mundëson një mbulim më të gjerë të territorit me fronte

dhe zgjerimin e rrjeteve të profesionistëve duke lehtësuar krijimin e një barriere më të qëndrueshme ndaj angazhimit në ekstremizëm të dhunshëm që çon në terrorizëm.

Në zbatim të procesit të rehabilitimit dhe ri-integrimit (R&R) të 24 (njëzet e katër) shtetasve shqiptarë të riadhesuar që përfshin procesin e ri-integrimit të 5 (pesë) shtetasve të kthyer më 27 tetor 2020 dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve të riadhesuar më 1 gusht, 2021 janë zhvilluar sesione/takime informuese, trajnime në nivel vendor dhe qendror dhe trajnime të ofruara për strukturat e përfshira drejtpërdrejt në këtë proces.

QKEDH ka koordinuar marrjen e masave për procesin e tretë të riadhesimit të shtetasve shqiptarë të mbetur në kampet e Sirisë dhe Irakut në datë 1 Gusht 2021. Nëpërmjet bashkëpunimit me partnerët, QKEDH ka bërë të mundur ofrimin e shërbimeve të nevojshme për periudhën e qëndrimit në Qendrën e Pritjes në Durrës, jo vetëm për grupin e të kthyerve, por edhe për stafin që punon me ta.

Me ardhjen e fëmijëve në Qendrën e Pritjes, QKEDH mundësoi koordinimin me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MASH), duke përcjellë kërkesën zyrtare për vlerësimin e njohurive të 14 (katërmëdhjetë) fëmijëve të kthyer nga Siria, me qëllim ri-integrimit e tyre në shkollë për vitin shkollor 2021-2022. Ky proces u zhvillua në 2 ditë dhe raportet e njohurive për çdo fëmijë u ndoqën duke përcaktuar klasat përkatëse që do të frekuentohen në komunitet.

Institucioni ynë ka qenë i pranishëm në vendosjen e familjeve në komunitet dhe ka koordinuar procesin e ecurisë së tyre të mëvonshme, me qëllim identifikimin dhe plotësimin e nevojave të shprehura nga këta qytetarë, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët e përfshirë në proceset e RRR.

Për këto familje janë zhvilluar takime me Grupet Teknike Ndërsektoriale (GTN), për çdo familje me qëllim monitorimin dhe ndjekjen e rasteve. Takimet organizohen gjithashtu për të diskutuar ecurinë e ri-integrimit të të miturve në shkolla dhe kopshte, çështjet e strehimit dhe mundësitë e punësimit.

Në kuadër të zhvillimit të Misionit të Vlerësimit nga KE, në lidhje me monitorimin e institucioneve dhe funksionimin efektiv të tyre mbi sfidat e paraqitura nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, QKEDH më datë 27 Shtator 2022 ka zhvilluar takime me ekspertët e Misionit të Vlerësimit mbi rishikimin e kornizës strategjike dhe legislative për kundër-

terrorizmin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm (CVE), takim në të cilin morën pjesë përfaqësues të zyrës së Kryeministrit, Drejtorisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Ministria e Mbrojtjes (MB).

Gjithashtu, QKEDH mori pjesë në takimin prezantues me autoritetet të zhvilluar në Ministrinë e Brendshme, SPAK, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financës dhe të Ekonomisë, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Informativ i Shtetit po me ekspertet e Misionit të Vlerësimit të Komisionit Evropian. Në përmbushje të këtij misioni, më datë 30.09.2022, QKEDH koordinoi dhe realizoi takimin me ekspertët e Misionit të Vlerësimit të KE dhe përfaqësues të komuniteteve fetare shqiptare.

Në muajin shtator 2022, Delegacioni i BE në Shqipëri ka dërguar komentet e tij mbi propozimet e autoriteteve shqiptare për ndryshimet/rishikimet në Planin e Veprimit. Ministria e Brendshme ka vijuar me reflektimin e komenteve dhe inputeve të institucioneve dhe do t'i përcjellë draftin e rishikuar Delegacionit të BE në Shqipëri për diskutimin dhe vijimin e procedurave të mëtejshme të miratimit të tij.

Prioritet i QKEDH do të jetë përballja dhe marrja e masave lidhur me pasojat e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit të cilat shtrihen edhe në rrafshin social. Masat do të marrin në konsideratë ndikimin negativisht në elementët socialë dhe etikë të shoqërisë, vlerat morale dhe normat shoqërore, integritetin e individit, sferën private, perceptimin e sigurisë publike, etj. Pas studimeve të kryera QKEDH është shprehur në takimin me Misionin e Vlerësimit se niveli i ulët arsimor, ndikimi i komuniteteve fetare jo zyrtare me tendencë radikale që nxit dhunën ekstreme dhe përdorimi i mjeteve online të propagandës dhe proselitizmi fetar janë bërë faktorë për radikalizimin e individëve që zhvillojnë prirje për të kryer akte terroriste.

Në takimet e zhvilluara me aktorët institucional QKEDH ka shprehur nevojën për të adresuar të gjitha zonat edhe ndërkufitare pasi rrezikshmëria më e lartë është evidentuar tek individët që vijnë kryesisht nga zonat e thella rurale, zonat pa investime në infrastrukturë, pa arsim, zona të cilat kanë probleme socio-ekonomike, kthehen në potencial të mundshëm për t'u radikalizuar duke mbajtur vëmendje të lartë edhe zonat urbane, sidomos kryeqyteti, pasi kanë rezultuar disa zona të nxehta "hotspot" për përhapjen e ideologjive radikale që çojnë në terrorizëm, si rasti i shtetasve që kanë udhëtuar drejt zonave të konfliktit në Siri dhe Irak. Nga kjo pikëpamje,

QKEDH ka vendosur disa masa edhe në komunikimin strategjik ku do të ketë një rol të rëndësishëm forcimi i aspektit social dhe etik të shoqërisë, duke promovuar vlerat morale dhe normat shoqërore, integritetin dhe etikën, sferën private, perceptimin e sigurisë publike, etj. Gjithashtu, në vijim të rekomandimeve që Misioni i BE, TAIEX përcolli, QKEDH ka kryer një vlerësim për ngirtjen e një institucioni i cili të analizojë dhe vlerësojë nivelin e rrezikut në nivel kombëtar, ka hartuar dhe nisur për konsultim projektvendimin “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kundër Terrorizmit dhe Ektremizmit (AKTE). Ky projektvendim është parashikuar të miratohet në 4 mujin e parë të 2023.

Gjatë periudhës Tetor- Dhjetor 2022, QKEDH ka vijuar me procesin koordinues dhe monitorues të zbatimit të Procesit të Re-habilitimit, Ri-socializimit dhe Ri-integrimit (RRR) të shtetasve shqiptarë të riatdhesuar nga vendet e konfliktit Siri dhe Irak, përkatësisht të 13 (trembëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 27 Maj 2022 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak; koordinimin dhe monitorimin e procesit të ri-integrimit të 19 (nëntëmbëdhjetë) shtetasve shqiptarë që u riatdhesuan më datën 1 Gusht 2021 nga kampet e ish vendeve të konfliktit, Siri dhe Irak; koordinimin dhe monitorimin e procesit të ri-integrimit të 5 (pesë) shtetasve të riatdhesuar në 27 Tetor 2020 nga këto vende (Siri dhe Irak), si dhe me realizimin e objektivave të Planit të Veprimit (P/CVE).

Në kuadër të planit të Ri-integrimit, QKEDH ka monitoruar, shqyrtuar, kontribuar dhe realizuar 78 raportime gjatë këtij tremujori. Këto janë raporte të mbështetjes psikologjike, mbështetjes edukative , informuese, vlerësimi për shtetasit e riatdhesuar, si dhe raporte periodike dërguar institucioneve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe, QKEDH ka koordinuar dhe ka marrë pjesë në 40 sesione trajnimi dhe forume për ngritje kapacitetesh për strukturat e përfshira drejtpërdrejtë dhe trajnime si në nivelin qendror, ashtu dhe në nivelin lokal të lidhura me procesin e ri-integrimit.

Qendra CVE vazhdon punën për riintegrimin dhe risocializimin e të kthyerve. Vazhdojnë përpjekjet për të përgatitur shërbimet publike lokale, si dhe komunitetet lokale për kthimin e FTF-ve të tjerë dhe familjeve të tyre.

Raportohet se ka përfunduar faza e konsultimit publik për Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022-2025 dhe Planet

e Veprimit në zbatim të saj të cilët janë konceptuar në dy dokumente specifike, një për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe një për Luftën kundër Terrorizmit. Theksohet se Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2022-2025 është vazhdim i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2011–2015, si detyrim i vendit për përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT).

Në periudhën raportuese QKEDH ka zhvilluar takimet e planifikuara me përfaqësues të GCERF, Terres de Hommes dhe Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, ku u diskutuan programet dhe aktivitetet të cilat janë zbatuar, ato të cilat do të zbatohen dhe fushat ku duhet të fokusohen më shumë në të ardhmen në programet P/CVE dhe R&R në Shqipëri. Në këto takime një theks i veçantë iu vu diskutimit mbi sfidat të cilat janë identifikuar brenda programeve R&R dhe gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e tyre sa më eficientë.

Në kuadër të procesit të integrimit të rikthyerve nga zonat e Siri-Irak, QKEDH koordinoi trajnimet e organizuara nga Tdh dhe Adriapol mbi zhvillimin e ideve të biznesit me fokus gratë e rikthyera nga zonat e luftës në kuadër të projektit “Prevention and Safe reintegration Holistic Approach and Resilience to Violent Extremism” në Shtator 2022.

Përgjatë muajit tetor 2022 raportohen kontribute nga QKEDH si në vijim:

- ✓ Në Tetor është zhvilluar ceremonia e fillimit dhe zbatimit të programit “Burgje të sigurta-Komunitete të sigurta- Qasje rehabilituese dhe ri integruese për personat në prag-lirie” e organizuar nga Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social. Në këtë event Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është përfaqësuar nga Drejtori i Qendrës, Z. Denion Meidani. Ai ka theksuar faktin se strategjitë dhe veprimet e zbatimit të shoqëruara me politikat dhe programet jo-ndëshkuese kundër radikalizmit e më pas edhe deradikalizimit që përfshijnë angazhimin dhe punën me programet e rehabilitimit të burgjeve për të siguruar zbatimin efektiv dhe qëndrueshmërinë e masave të lidhura me to, janë një domosdoshmëri. Zhvillimi i kornizave dhe mjeteve të

klasifikimit të të burgosurve ashtu sikurse zhvillimi i metodologjisë së menaxhimit të të burgosurve ekstremistë, përditësimi i programeve të rehabilitimit dhe ri integrimin, apo ndërhyrje të koordinuara shume shtresorë që synojnë shkëputjen e të burgosurve ekstremistë nga dhuna dhe lehtësimin e ri integrimin të tyre social pas lirimit janë themelore për tu implementuar në këtë program.

- ✓ Në kuadër të “Projektit Forcimi i kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizmit në burgje në Ballkanin Perëndimor, Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022” në Tetor u zhvillua Konferenca Rajonale me temë “Drejt Menaxhimit të suksesshëm, rehabilitimit dhe ndihmës pas vuajtjes së dënimit për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (VEP) në Ballkanin Perëndimor- arritjet dhe rruga përpara” e organizuar nga Këshilli i Evropës me përfaqësues të Bashkimit Evropian, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Drejtorja e Burgjeve, Policia e Shtetit si dhe institucione të tjera lidhur me çështjet e diskutuara në konferencë. Në këtë konferencë drejtori i Qendrës CVE z. Denion Meidani ka kontribuar mbi metodologjinë e menaxhimit të të burgosurve ekstremistë, parandalimin e progresit të ekstremizmit të dhunshëm në burgje, si dhe për ndërhyrje të cilat synojnë ndalimin e përfshirjes të të burgosurve ekstremistë në akte dhunë dhe për lehtësimin e ri integrimin të tyre në komunitet pas përfundimit të dënimit.
- ✓ QKEDH ka marr pjesë në takimin e 7-të i komitetit drejtues të Programit “Forcimi i kapaciteteve penitenciare në adresimin e radikalizmit në burgje në Ballkanin Perëndimor, Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”. Gjatë këtij takimi i prezantuan rezultatet, arritjet dhe sfidat që ka patur ky projekt gjatë periudhës së implementimit në të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu në këtë takim u prezantua Projekti i ri, vazhdimësi e projektit të sipërpërmendur. Projekti “Instrumenti Horizontal III 2023 – 2026: Rritja e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të Dhunshëm në burgje dhe parandalimin e radikalizmit të mëtejshëm pas lirimit” .
- ✓ Në vijim të bashkëpunimit dhe marrëdhënies frytdhënëse me institucionet partnere ndërkombëtare në kuadër të parandalimit dhe kundërshtimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, QKEDH mori pjesë në aktivitetet që u organizuan në Sarajeve, Bosnjë dhe Hercegovinë në Tetor 2022.

- ✓ Drejtori i QKEDH-së në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm i ftuar nga Këshilltari Rajonal kundër Terrorizmit dhe Sigurisë i Delegacionit të BE-së në Sarajevë, mori pjesë në takimin e radhës të Rrjetit Rajonal të Koordinatorëve Kombëtarë CT-P/CVE (RNNC) të Ballkanit Perëndimor. Në këtë takim Drejtori i QKEDH kontribuoi duke prezantuar zhvillimet më të reja me fokus planet e rehabilitim – ri integrim – risocializimit dhe ndikimet e mundshme në Shqipëri të agresionit të pa provokuar Rusisë në Ukraine.
- ✓ Në takimin e datës 12 Tetor, QKEDH mori pjesë në takimin e dytë të Komitetit Drejtues ftuar për të marrë pjesë nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Qëllimi i përgjithshëm i këtij takimi ishte prezantimi i aktiviteteve të projektit dhe dakordësimi me planin e ardhshëm të përbashkët të veprimit, eksplorimi i mënyrave të ardhshme të shkëmbimeve dhe njohuri mbi risocializimin dhe rehabilitimin e personave të kthyerve nga zonat e konfliktit.
- ✓ Gjithashtu në datë 12 Tetor QKEDH mori pjesë dhe kontribuoi në Takimin e Grupit Mbështetës të Shtyllës 1 të WBCT-i i organizuar nga IISG (Integrative Internal Security Governance).
- ✓ Në vijim të bashkëpunimit që Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) ka me vendet e rajonit dhe veçanërisht me homologet në Kosovë në kuadër të parandalimit dhe kundërshtimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, me mbështetjen dhe koordinimin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri QKEDH ishte pjesë e delegacionit shqiptar që zhvillojë vizitën studimore në Prishtinë, Republika e Kosovës në datat 18 – 19 Tetor 2022. Qëllimi i vizitës ishte njohja e delegacionit Shqiptar me sistemin e menaxhimit të të dhënave “database” të cilën Republika e Kosovës përdor ne sistemin e burgjeve për regjistrimin e personave të cilët vuajnë dënime të ndryshme për vepra penale që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizimin si dhe të atyre individëve që shfaqin sjellje apo shenja të hershme të radikalizmit në këto institucione.

Përgjatë muajit nëntor 2022 raportohen kontribute nga QKEDH si në vijim:

- ✓ Me qëllim përgatitjen për takimin bilateral për Kapitullin 24 i zhvilluar në Bruksel në datat 8, 9, 10 Nëntor, QKEDH mori pjesë në takimin e përbashkët të zhvilluar në drejtorinë e Antiterrorit me qëllim dhënien e kontributeve këtë fushë.

- ✓ Në kuadër të procesit të integrimit të të rikthyerve nga zonat e Siri-Irak, QKEDH koordinoi trajnimet në vazhdim të atyre të zhvilluara gjatë muajit Shtator të organizuara nga TdH dhe Adriapol mbi zhvillimin e ideve të biznesit me fokus gratë e rikthyera nga zonat e luftës në kuadër të projektit “Prevention and Safe reintegration Holistic Approach and Resilience to Violent Extremism” të mbajtura në Nentor 2022. Përmes tyre garantohet mbështetja edhe për disa ditë nëpërmjet një procesi mentorimi, në mënyre që përfitueset të kenë mundësinë që bashkë me mentoretë finalizojnë një plan biznesi të mirëfilltë, i cili me pas të mund të financohet e të jete baza për të filluar proceset e vetëpunësimit dhe jetesës së pavarur.
- ✓ Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm zhvilloi një vizitë zyrtare dy ditore në Qeverinë e Maqedonisë së Veriut. Në këtë vizitë, Z. Meidani u prit nga homologu i tij, Z. Zlatko Apostoloski në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Terrorizimit në Maqedoninë e Veriut, dy Zv. Koordinatorët Kombëtar Z. Xheladin Ajvazi dhe Z. Zlatko Arsov, Znj. Natasha Vidova, përfaqësuese e UN IOM Skopje si dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë së Maqedonisë së Veriut të përfshirë në këtë fushë. Qëllimi i vizitës ishte rritja e bashkëpunimit bilateral dhe rajonal në luftën e përbashkët kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe çdo lloj veprimtarie të lidhur me të.
- ✓ Në nëntor në Romë është mbajtur konferenca ‘RCC Jumbo Security Conference’ e cila përfaqëson mbledhjen më të madhe të të gjithë profesionistëve, organizatave dhe rrjeteve rajonale të sigurisë që merren me çështjet e sigurisë në Evropën Juglindore dhe në veçanti në Ballkanin Perëndimor ku kontribuoi Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm e përfaqësuar nga Drejtori i qendrës Z. Denion Meidani. Ky organizim fokuson vëmendjen e aktorëve rajonalë dhe ndërkombëtarë të sigurisë në rajonin tonë dhe ndihmon gjithashtu në krijimin e lidhjeve thelbësore për koordinimin dhe racionalizimin e përpjekjeve të bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Objektivi kryesor i këtij edicioni të 7-të të ngjarjes ka pasur për qëllim adresimin dhe përcaktimin e tendencave kryesore të sigurisë që lindën (ose do të jenë në të ardhmen e afërt) nga pasiguritë aktuale rajonale dhe evropiane dhe që do të formësojnë të ardhmen sigurisë së Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Konferenca u organizua nga RCC (Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit) në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme Italiane dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

- ✓ Në Nëntor 2022, Drejtori i Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), kontribuoi në workshopin e zhvilluar nga RAN me temë: Konfrontimi i Gjuhës së Urrejtjes në Ballkanin Perëndimor, i cili u zhvillua në Podgoricë - Mali i Zi.
- ✓ Gjatë periudhës raportuese QKEDH kontribuoi në grupin e punës për takimin e punës “Wachlisting – WASP” që u organizua në Budva, Mali i Zi në Dhjetor 2022, ftuar nga Ambasada Amerikane në Shqipëri.

Me qëllim ardhjen në ndihmë me sa më shumë komponentë të familjeve dhe fëmijëve të të rikthyerve, QKEDH në bashkëpunim me përfaqësues të kompanisë Mini Invest Albania shpk, kanë finalizuar dorëzimin e ndihmave ushqimore, të siguruara nga Mini Invest Albania shpk pranë Komunitetit Rinor Nr. 1 SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Gjithashtu, QKEDH në bashkëpunim me përfaqësues të Alba Shoes Group, kryen dorëzimin e 13 (trembëdhjetë) palëve këpucë, të siguruara nga Alba Shoes Group pranë Komunitetit Rinor Nr. 1 SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri.

Për sa i përket bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, QKEDH ka marrë pjesë në takimet me përfaqësues të Bashkimit Evropian (BE) në vend në kuadër të projektit : “Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për të përballuar sfidat që lidhen me riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) dhe familjet e tyre të kthyer nga zonat e konfliktit” që po implementimet nga IOM në Shqipëri me mbështetjen financiare të BE.

Vlen të theksohet edhe fakti se QKEDH ka marrë pjesë në takimet e grupit ndër-institucional të punës për hartimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare e cila u zhvillua pranë Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ). QKEDH dha ndihmesën e saj paraprake në zërat përkatës që përfshihen në këtë strategji si kundërshtimi i radikalizimit apo ekstremizmit të dhunshëm.

Përgjatë periudhës raportuese është organizuar me mbështetjen e IOM në Shqipëri një takim dypalësh me homologët e Republikës së Kosovës në kuadër të projektit të mbështetur nga IOM në Shqipëri dhe BE “Ndërtimi i kapaciteteve institucionale në Ballkanin Perëndimor për t'u marrë me sfidat që lidhen me risocializimin e ri integritit dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer (RFTF) dhe familjeve të tyre nga zonat e konfliktit”. Takimi ka pasur si

qëllim diskutimin dhe përcaktimin e prioriteteve të Planit të Punës për Rehabilitim dhe Integrim. Duke pasur parasysh fokusin dhe natyrën e ndjeshme të programeve të RRR-së të fokusuara në kthimin dhe ri integrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit pjesëmarrësit të cilët kanë kontribuar kanë qenë anëtarë të grupit të punës ndërinstitucional, në nivel qendror dhe vendor.

6. AKTIVITETI RAPORTUES DHE MONITORUES

Në kuadrin e këtij objektivi raportohen aktivitete vijuese ku QKEDH:

- ✓ përcolli pranë ILDKPKI raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer nga institucioni ynë në zbatim të ligjit nr. 9367 dt. 07. 04. 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- ✓ realizoi raportime periodike për Kryenegociatorin mbi pasqyrimet dhe rekomandimet e progres raportit për “Kapitullin 24” dhe për “Kapitullin 31” si dhe për Ministrinë e Brendshme (MB) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ).
- ✓ përcolli në mënyrë shkresore pranë Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) raportin për muajt Tetor-Dhjetor në kuadër të procesit të ri-integrimit dhe rehabilitimit.
- ✓ kryerja e inventarizimit të aktiveve
- ✓ vijoi me plotësimin e dosjeve fizike të shtetasve të riatdhesuar nga Siria dhe Iraku me informacion të përditësuar në kuadër të procesit të ri-integrimit që po zbatohet.
- ✓ përcolli pranë Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse raportin "Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2023, 2024, 2025.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm përgjatë periudhës së 6-mujorit të dytë Korrik- Dhjetor 2022, vlerësoi si prioritete të rëndësishme të punës së saj, ndërhyrjet në drejtim të zbatimit të programeve rehabilituese dhe ri integruese që po i ofrohen shtetasve shqiptarë në komunitet si dhe shtetasve të kthyer nga zonat e konfliktit Siri dhe Irak. Po ashtu është punuar për të zbatuar veprimtaritë e planifikuara me një qasje prioritare kundrejt komunikimit strategjik që duhet të ndërmerret në këtë drejtim. Hartimi i Planit të Veprimit 2022-2025 të QKEDH-së është një tjetër prioritet i rëndësishëm i institucionit tonë për ta finalizuar në bashkërendim me institucionet relevante të linjës.

7. PROBLEMATIKA

Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale për të gjitha strukturat e kategorizuara në të ashtuquajturën “qasje e butë”, por jo vetëm, që do të angazhohet në riatdhesimin e shtetasve shqiptarë që ndodhen aktualisht në zonat e konfliktit, Siri dhe Irak. Të gjitha programet e riintegritimit për këtë kategori, përfshirë gratë/vajzat dhe fëmijët, kërkojnë angazhim të vazhdueshëm dhe afatgjatë të burimeve financiare dhe njerëzore në terren. Aktualisht, këto burime mbeten ende të kufizuara.

QKEDH në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit synon të ndërhyjë në kurrikulën bazë arsimore për ta pasuruar atë në kuadrin e njohurive arsimore të përgjithshme të nxënësve shqiptarë duke iu referuar konceptit bazë.

Nga ana tjetër, po zhvillohet një proces aktiviteti për krijimin e platformave të edukimit digjital, ku veçanërisht të rinjtë mund të shkëmbejnë ide dhe të ndërtojnë narrativa alternative efektive për t’iu kundërvënë këtij fenomeni, një qasje e cila do të kontribuojë në zhvillimin e të menduarit kritik për çështje të tilla si demokracia, feja, të drejtat dhe liritë e individit etj.

Dukuria e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vendin tonë kërkon një “qasje shumëdimensionale” dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve qendrorë dhe vendorë në zbatimin e kuadrit ligjor strategjik në fuqi, me qëllim parandalimin dhe zhvillimin e alternativave të qëndrueshme.

Gjatë periudhës raportuese është theksuar angazhimi i QKEDH, për pasojë raportohen disa nevoja të cilat do adresohen në periudhën e ardhshme raportuese në nivel kapaciteti institucional dhe veprimi në të gjitha fushat ku operon QKEDH, dhe më konkretisht:

1. Nevojë urgjente për rritjen e numrit të punonjësve nisur nga fusha e veprimtarisë dhe përgjegjësisë së QKEDH pasi organika aktuale 1+7 ka sjellë mbingarkesë për të gjithë punonjësit e QKEDH duke kryer më shumë se dy detyra funksionale në të njëjtën kohë.

2. Nevoja urgjente e një mjete transporti nisur nga angazhimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe gjendja aktuale e mjeteve të QKEDH në dispozicion ku nga tre mjete në inventar vetëm një mjet është në gjendje funksionale aktualisht, pasi dhe ky mjet ka nevojë për shërbime.
3. Nevojë urgjente për ambiente pune (zyra) pasi zyrat aktuale akoma nuk janë me një status të qartë qëndrimi për QKEDH.
4. Prioritizim i miratimit të Urdhrit të Kryeministrit për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm i cili do të shërbejë si mekanizëm kombëtar referimi, pasi një mekanizëm i tillë mungon duke sjellë vështirësi dhe pamundësi të evidentimit të rasteve dhe fenomeneve në kohë me qëllim adresimin e tyre.